


Tregtia e jashtme e mallrave

Shkurt 2017

Tiranë, më 17 Mars 2017: Në Shkurt 2017, eksportet e mallrave arritën vlerën 20 mld lekë, duke u rritur me 14,2 %, në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë dhe me 6,2 %, në krahasim me Janar 2017. Importet e mallrave në Shkurt 2017, arritën vlerën 44 mld lekë duke u rritur me 4,8 %, në krahasim me një vit më parë dhe me 24,7 %, në krahasim me Janar 2017. Deficiti tregtar i këtij muaji është 24 mld lekë, duke u ulur me 1,9 %, krahasuar me Shkurt 2016 dhe duke u rritur me 46,2 %, në krahasim me Janar 2017.

Fig. 1 Ndryshimi vjetor në tregtinë e jashtme, Shkurt 2013 – Shkurt 2017




Në dy muajt e parë 2017, eksportet e mallrave arritën vlerën 39 mld lekë, duke u rritur me 14,8 % krahasuar me një vit më parë dhe importet e mallrave arritën vlerën 79 mld lekë, duke u rritur me 3,0 % krahasuar me një vit më parë. Deficiti tregtar arriti vlerën 40 mld lekë, duke u ulur me 6,3 % krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2016.

Ndikimi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të eksporteve:

Në Shkurt 2017, rritja vjetore e eksporteve prej 14,2 % është ndikuar kryesisht nga grupet: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me +7,6 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me +5,8 pikë përqindje, “Tekstile dhe këpucë” me +1,3 pikë përqindje. Në ndryshimin vjetor të eksporteve ka ndikuar negativisht grupet: “Ushqim, pije, duhan” me -0,5 pikë përqindje, “Lëkurë dhe artikuj prej tyre” me -0,2 pikë përqindje, “Prodhime druri dhe letre” me -0,1 pikë përqindje.

Fig.2 Ndikimi i grupeve në ndryshimin vjetor të eksporteve, Shkurt 2017




Në dy muajt e parë 2017, eksportet janë rritur me 14,8 % krahasuar me një vit më parë. Grupet që kanë ndikuar pozitivisht në rritjen vjetore të eksporteve, janë: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me 9,4 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me +4,1 pikë përqindje, “Tekstile dhe këpucë” me +2,4 pikë përqindje. Grupet që kanë ndikuar negativisht në ndryshimin vjetor të eksporteve, janë: “Ushqim, pije, duhan” me -0,8 pikë përqindje, “Lëkurë dhe artikuj prej tyre” me -0,4 pikë përqindje, “Prodhime druri dhe letre” me -0,1 pikë përqindje.

Ndikimi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të importeve:

Në Shkurt 2017, rritja vjetore e importeve prej 4,8 %, është ndikuar kryesisht nga grupet: “Makineri, pajisje këmbimi” me 2,1 pikë përqindje, “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me 1,6 pikë përqindje, “Tekstile dhe këpucë” me 1,1 pikë përqindje. Në ndryshimin vjetor të importeve ka ndikuar negativisht grupet: “Materiale ndërtimi dhe metale” me -0,8 pikë përqindje, “Ushqim, pije, duhan” me -0,4 pikë përqindje, “Lëkurë dhe artikuj prej tyre” me -0,01 pikë përqindje.

Fig.3 Ndikimi i grupeve në ndryshimin vjetor të importeve, Shkurt 2017



Në dy muajt e parë 2017, importet janë rritur me 3,0 %, krahasuar me një vit më parë. Grupet që kanë ndikuar pozitivisht në rritjen vjetore të eksporteve, janë: “Produkte kimike dhe plastike” me +2,1 pikë përqindje, “Tekstile dhe këpucë” me +1,3 pikë përqindje, “Ushqim, pije, duhan” me 0,3 pikë përqindje. Grupet që kanë ndikuar negativisht në ndryshimin vjetore të eksporteve, janë: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me -0,6 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me -0,6 pikë përqindje, “Prodhime druri dhe letre” me -0,3 pikë përqindje.

Ecuria e tregtisë së mallrave sipas vendeve partnere


Në muajin Shkurt 2017, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të eksporteve, në krahasim me Shkurt 2016 janë: Italia me (5,3 %), Kosova me (40,1 %) dhe Spanja me (69,5 %). Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur uljen më të madhe janë: Bullgaria me (-22,4 %), Holanda me (-8,3 %) dhe Austria me (-53,1 %).

Në dy muajt e parë 2017, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të eksporteve, në krahasim me një vit më parë, janë: Italia me (9,1 %), Kosova me (36,5 %) dhe Spanja me (120,7 %). Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur uljen më të madhe, janë: Hungaria me (-13,4 %), Holanda me (-4,6 %) dhe Austria me (-34,6 %).

Në muajin Shkurt 2017, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të importeve, në krahasim me Shkurt 2016 janë: Gjermania me (19,3 %), Turqia me (18,6 %) dhe Greqia me (8,5 %). Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur uljen më të madhe janë: Italia me (-5,7 %), Kina me (-12,8 %) dhe Çekia me (-35,4 %).

Në dy muajt e parë 2017, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të importeve, në krahasim me një vit më parë, janë: Turqia me (8,8 %), Gjermania me (16,3 %) dhe Greqia me (4,6 %). Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur uljen më të madhe, janë: Italia me (-7,5 %), Kina me (-7,4 %) dhe Serbia me (-14,3 %).

Fig. 4 Tregtia e jashtme e mallrave sipas disa vendeve të BE-së, Shkurt 2017



Shkëmbimet tregtare me vendet e BE zënë 66,9 %, të gjithë tregtisë. Në Shkurt 2017, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 78,1 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 61,8 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (37,7 %), Gjermania (7,3 %), Greqia (6,8 %) dhe Kina (6,6 %).

Shkëmbimet tregtare, për këtë periudhë, me vendet e BE zënë 64,0 % të gjithë tregtisë. Në dy muajt e parë 2017, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 80,6 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 55,8 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (39,0 %), Kina (7,0 %), Gjermania (6,7 %) dhe Greqia (6,5 %).

Tab. 1 Qarkullimi i mallrave (miliardë lekë)

Vitet	Muajt	Eksporte	Ndryshimi Vjetor	Importe	Ndryshimi Vjetor	Bilanci Tregtar	% e mbulimit
2000		37	-23,5	157	-1,5	-120	23,6
2001		44	19,1	190	21,0	-146	23,2
2002		47	7,7	210	10,6	-163	22,6
2003		54	14,7	226	7,4	-171	24,1
2004		62	14,0	236	4,5	-174	26,3
2005		66	6,0	262	11,1	-196	25,1
2006		77	17,6	299	14,1	-222	25,9
2007		97	25,5	376	25,8	-279	25,8
2008		113	15,8	440	16,9	-327	25,6
2009		105	-7,2	429	-2,5	-324	24,4
2010		162	54,6	478	11,4	-316	33,8
2011		197	21,9	544	13,9	-347	36,2
2012		213	8,2	528	-2,9	-315	40,3
2013		246	15,7	517	-2,1	-271	47,6
2014		256	3,8	552	6,7	-297	46,3
2015		243	-4,9	545	-1,4	-301	44,7
2016		243	0,1	579	6,4	-336	42,0
2014	01 - 14	18	-1,4	35	2,2	-17	51,2
	02 - 14	20	27,9	39	17,5	-19	51,8
	Janar-Shkurt 2014	38	12,3	74	9,8	-36	51,5
2015	01 - 15	18	-0,6	35	0,9	-17	50,4
	02 - 15	18	-9,4	39	-0,8	-20	47,3
	Janar-Shkurt 2015	36	-5,3	74	0,03	-38	48,8
2016	01 - 16	16	-7,8	35	-1,0	-18	47,0
	02 - 16	18	-4,4	42	7,6	-24	42,0
	Janar-Shkurt 2016	34	-6,0	77	3,5	-43	44,3
2017	01 - 17	19	15,5	35	0,9	-16	53,8
	02 - 17	20	14,2	44	4,8	-24	45,8
	Janar-Shkurt 2017	39	14,8	79	3,0	-40	49,3

Tab. 2 Tregtia e jashtme e mallrave sipas vendeve partnere (milionë lekë)

	Eksporte				Importe			
	16-Shk	17-Shk	Jan.- Shk.2016	Jan.- Shk. 2017	16-Shk	17-Shk	Jan.- Shk.2016	Jan.- Shk. 2017
Vendet e BE-së	15.137	15.679	27.279	31.435	27.026	27.124	44.554	44.122
Austri	147	69	237	155	639	372	827	642
Mbretëri e Bashkuar	29	15	59	53	377	385	587	698
Gjermani	708	878	1.332	1.613	3.161	3.770	5.376	6.254
Greqi	789	920	1.464	1.655	3.147	3.413	5.744	6.006
Itali	10.716	11.282	21.099	23.019	13.632	12.861	24.941	23.083
Spanjë	551	933	821	1.812	686	797	1.188	1.396
Kroaci	41	50	76	91	265	322	519	580
Të tjera të BE-së	2.157	1.532	2.191	3.037	5.119	5.204	5.373	5.464
Kinë	212	709	575	1.310	4.028	3.513	7.450	6.899
Kosovë	1.033	1.447	1.749	2.389	299	509	525	860
Maqedonia	276	608	456	885	426	565	794	906
Rusi	1	6	1	6	185	407	889	1.314
SHBA	92	95	188	244	817	572	1.479	1.423
Turqi	61	172	160	279	2.969	3.522	5.767	6.272
Ukrainë	23	42	34	122	221	251	330	540
Zvicër	109	192	181	268	545	755	1.148	1.190
Të tjera	648	1.137	3.346	2.072	5.325	6.651	13.785	15.527
Gjithsej	17.592	20.087	33.972	39.010	41.841	43.867	76.720	79.054

Tab. 3 Tregtia e jashtme sipas grup mallrave (milionë lekë)

Grup-mallrat	Eksporte				Importe			
	16-Shk	17-Shk	Jan.- Shk. 2016	Jan.- Shk. 2017	16-Shk	17-Shk	Jan.- Shk.2016	Jan.- Shk. 2017
Gjithsej	17.592	20.087	33.972	39.010	41.841	43.867	76.720	79.054
Ushqime, pije, duhan	1.662	1.571	3.124	2.841	7.158	7.009	13.587	13.827
Minerale, lëndë djegëse, en.el.	2.331	3.663	4.379	7.585	3.481	4.136	8.023	7.528
Produkte kimike dhe plastike	290	298	537	543	6.517	6.628	10.446	12.070
Lëkurë dhe artikujt prej tyre	243	207	518	383	1.164	1.159	2.182	2.255
Prodhime druri dhe letre	630	606	1.221	1.175	1.669	1.697	2.992	2.760
Tekstile dhe këpucë	8.889	9.116	17.329	18.137	6.127	6.585	11.002	11.988
Materiale ndërtimi dhe metale	2.111	3.139	4.134	5.511	5.054	4.719	8.807	8.357
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	892	999	1.711	1.879	9.207	10.103	17.262	17.130
Të tjera	544	487	1.019	955	1.466	1.831	2.419	3.139

Tab. 4 Eksportet sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë, (Jan.- Shk. 2016, Jan.-Shk. 2017)

(milionë lekë)

	Itali		Kosovë		Spanjë		Greqi	
	2016	2017	2016	2017	2016	2017	2016	2017
Gjithsej	21.099	23.019	1.749	2.389	821	1.812	1.464	1.655
Ushqim, pije duhan	1.422	970	285	244	120	120	284	247
Minerale, lëndë djegëse, ener. elek.	568	2.276	348	1.040	256	1.342	48	43
Produkte kimike dhe plastike	245	208	117	121	-	0	39	67
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	474	300	0	-	-	3	7	8
Prodhime druri dhe letre	963	886	37	52	1	1	105	119
Tekstile dhe këpucë	13.890	14.458	10	13	345	273	731	758
Materiale ndërtimi dhe metale	1.842	2.224	691	688	91	72	186	304
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	1.188	1.222	87	76	2	0	19	51
Të tjera	506	473	174	156	6	0	45	58

Tab. 5 Importet sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë, (Jan.- Shk. 2016, Jan.-Shk. 2017)

(milionë lekë)

	Itali		Kinë		Turqi		Gjermani	
	2016	2017	2016	2017	2016	2017	2016	2017
Gjithsej	24.941	23.083	7.450	6.899	5.767	6.272	5.376	6.254
Ushqim, pije duhan	2.492	2.384	63	121	682	770	591	531
Minerale, lëndë djegëse, ener. elek.	2.798	2.311	2	1	49	169	97	92
Produkte kimike dhe plastike	2.197	2.500	606	767	835	949	793	1.014
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	1.803	1.789	132	96	25	41	1	0
Prodhime druri dhe letre	1.012	864	146	171	371	331	117	96
Tekstile dhe këpucë	6.020	6.075	1.241	1.619	1.923	2.060	309	331
Materiale ndërtimi dhe metale	2.494	2.387	2.141	903	699	777	160	164
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	5.440	4.088	2.633	2.504	964	837	3.144	3.837
Të tjera	685	685	486	718	218	339	165	189

Përkufizime

Eksportet janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë, të vendosura nën regjimin doganor, në përpunimin pasiv, ose të rieksportuar pas përpunimit aktiv.

Vlera F.O.B: Është vlera e mallrave të eksportuara deri në kufirin e vendit eksportues, pra përfshin koston e mallrave të eksportuara dhe shpenzimet deri në kufi të vendit eksportues.

Importet janë në përgjithësi mallra që vinë nga një vend i tretë, të vendosura direkt në qarkullim të lirë ose që qëndrojnë në magazinat e ruajtjes nën procedurat doganore të lejimit për qarkullim të lirë, për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor.

Vlera C.I.F: Është vlera e mallrave të importuara dërguar deri në kufirin e vendit importues, pra përfshin koston e mallit, edhe shpenzimet e transportit dhe sigurimit deri në kufirin e vendit që importon mallrat.

Nomenklatura e Kombinuar (NK) është një nomenklaturë mallrash e përdorur për statistikat e tregtisë ndërkombëtare të mallrave dhe për tarifatat doganore.

<http://www.instat.gov.al/al/metodologji/klasifikime-nomenklatura.aspx>;

Vendet anëtare të Bashkimit Evropian: Belgjikë, Gjermani, Francë, Itali, Luksemburg, Holandë, Mbretëria e Bashkuar, Danimarkë, Irlandë, Greqi, Spanjë, Portugali, Austri, Finlandë, Suedi, Qipro, Çeki, Estoni, Hungari, Letoni, Lituani, Maltë, Poloni, Sllovaki, Slloveni, Bullgari, Rumani, Kroaci.

Shpjegimi i simboleve

0 vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse

- pa vlerë

÷ deri